

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

Të nderuar kolegë dhe bashkëqytetarë,

Unë sot, si përfaqësues i qarkut Dibër, ndihem i papërfaqësuar, ndihem i vjedhur në këtë parlament nga kjo qeveri, e cila është produkt i krimit, korrupsionit dhe propagandës.

Më 25 prill jam përballur jo me zgjedhje, por me një masakër zgjedhore të vërtetë, si asnjëherë tjetër në këta 30 vjet demokraci. Është kënaqësi, privilegj dhe, njëherazi, përgjegjësi që të përfaqësoj qarkun Dibër në këtë parlament. Një krahinë që ka lënë gjurmë në historinë kombëtare, me shpirt demokrat dhe e gatshme për t'u përballur me të keqen, ku më 25 prill triumfoi ndaj kësaj të keqeje të madhe që mban emrin "Rilindje". Qytetarët ishin në rezonancë të plotë me forcën tonë politike jo vetëm për shkak të pakënaqësisë 8-vjeçare të "Rilindjes", por, edhe për shkak të shpresës që ngjalli platforma jonë qeverisëse, si më e mira e 30 vjetëve demokraci. Platforma jonë ishte e detajuar, optimiste dhe shpresëplotë, e cila në themel të saj kishte mirëqenien e familjes, rritjen e punësimit, zhvillimin e infrastrukturës dhe ekonomisë, uljen e taksave e tatimeve, zhvillimin e biznesit, mbështetjen e bujqësisë dhe të agroturizimit, si dhe integrimin e Shqipërisë në BE. Dua të theksoj se qarku i Dibrës është qarku më i varfër i Shqipërisë; me infrastrukturën publike më të rrënuar; me rrugë të paasfaltuara, me shkolla të shkatërruara, madje 8 vjetët e fundit janë mbyllur më shumë se 50% e shkollave, një politikë diskriminuese e kësaj qeverie, me papunësinë më të lartë në vend; me bujqësi të rrënuar dhe me mijëra hektarë tokë djerrë pa sistem vaditje e pa asnjë subvencionim nga shteti dhe me nivelin ekonomik të familjes më të ulët në Shqipëri; me eksodin politik dhe ekonomik rekord jo vetëm në Europë, por edhe në botë. Banka Botërore, në një artikull të saj të fundvitit të kaluar e konsideronte Veriun e Shqipërisë si rajonin më të varfër të Europës, ku me keqardhje mund të them se qarku i Dibrës është qarku më i varfër jo vetëm i Shqipërisë, por edhe i Europës. Ky është një diskriminim i pastër politik, por edhe një diskriminim krahinor, që i është bërë këtij qarku dhe Veriut në përgjithësi.

Pavarësisht resurseve të jashtëzakonshme hidroenergjetike, pasurive nëntokësore apo bujqësisë dhe agroturizimit, përsëri kjo zonë vazhdon të jetë e diskriminuar në raport me zonat e tjera. Në zgjedhjet e vitit 2013 ju erdhët në pushtet me një gamë të jashtëzakonshme premtimesh elektorale, si: 300 mijë vende pune, dyfishim pagash e pensionesh dhe shëndetësi falas, por asnjërin prej tyre nuk e mbajtët. Madje, edhe tani që ka filluar mandati i tretë, ende nuk ka filluar asnjë nga zbatimi i premtimeve të vitit 2013, përkundrazi, keni bërë hapa pas, duke e renditur Shqipërinë në fund të listës në çdo parametër europian e botëror. Zgjedhjet lokale të Dibrës të vitit 2016 ishin pilotimi i një maskarade zgjedhore. Dosja nr. 184 është ende e hapur, ku Kryeministri aktual, ish-ministra apo ministra, që kërkojnë votëbesimin në këtë parlament, janë aktorët kryesorë të kësaj dosjeje, që akoma nuk është mbyllur.

Në vitin 2016 u mboll me drogë e gjithë Shqipëria. Ndërsa në vitin 2017 blerja dhe tjetërsimi i votave u shtrinë në të gjithë Shqipërinë dhe për vitin 2017 ekziston dosja nr. 339. Rilindja nuk heq dorë për asnjë moment nga blerja e votës, ajo nuk konkurren me platformë qeverisëse, por konkurren me blerje dhe tjetërsim votash. Më 25 prill kjo qeveri përdori çdo instrument antiligjor për zbatimin e strategjisë së sofistikuar, tashmë të tjetërsimit të votave, duke hedhur në sulm arsenalin shtetëror, si: shpërndarje parash, ku kemi të paktën tri raste të kapjes së tyre me lekë dhe me lista familjesh, dhënie

tapish dhe legalizimesh, ndërtime me apo pa leje, punësime sezonale, presione policore, gjoba ndaj bizneseve dhe votuesve të djathtë, mbifaturime nga OSHEE-ja, përdorimi i Policisë së Shtetit, duke shfrytëzuar pandeminë, shpërndarjen e tollonave për subvencionimin e bujqësisë në prag zgjedhesh, si dhe ndalimin e emigrantëve të shumtë që vijnë nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut për të votuar. U përdorën votat e parlamentit ilegjitim për prishjen e koalicioneve zgjedhore, u përdor emetimi i fletës së votimit jashtë vullnetit të palëve, që prodhoi rreth 83 mijë vota të pavlefshme, ku shumica dërrmuese e tyre ishin të djathta. U përdor administrata shtetërore, e përbërë prej 185 mijë vetash, që përbëjnë rreth 26% të të punësuarve sot në Shqipëri, si dhe vetëm në 6 muajt e fundit, pra nga muaji shtator deri në muajin mars të këtij viti, u punësuan 13 mijë të tjerë, që ishte një numër rekord, duke thyer edhe rekordin 20-vjeçar. Nëse në sektorin privat ka ndodhur e kundërta, në administratën shtetërore numri i të punësuarve rritet në një progresion të jashtëzakonshëm. Të punësuarit u kthyen, nga ana e rilindjes, në patronazhistë të qytetarëve, të cilët morën përsipër jo vetëm votën e tyre dhe të familjarëve të tyre, por edhe të dhjetëra e dhjetëra qytetarëve të tjerë, duke cenuar privatësinë e të dhënave personale të çdo qytetari në Shqipëri. Në prag zgjedhesh ju përdorët investimet korruptive në rrugë, ujësjellës e kanalizime, madje në ditët e fundit të fushatës ju shfrytëzuat dy fatkeqësitë natyrore, tërmetin dhe pandeminë, duke i përdorur paratë për fushatë elektorale. Me mijëra familje dhe biznese të majta u shpërblyen padrejtësisht për tërmetin, duke u dhënë para kesh në prag të fushatës elektorale dhe u persekutuan familjet demokrate. Dhjetëra godina publike, si: shkolla, kopshte apo qendra shëndetësore në qarkun e Tiranës, të Lezhës dhe të Durrësit u shembën. Madje, u shembën padrejtësisht edhe shkolla të ndërtuara nga Banka Botërore në Kamëz, ku katër prej tyre ishin ndërtuar me standarde të Bashkimit Europian dhe njëra prej tyre me fondet e Komisionit Europian. Një pjesë e tyre janë ndërtuar nga e para me një vlerë 2-3 herë më shumë se financimi i Bankës Botërore dhe ristrukturimi i dy apo tre të tjerave kushtoi 3 herë më shumë sesa kur janë ndërtuar në fillim.

Kjo është strategjia që ka përdorur qeveria për të dalë nga kjo katastrofë natyrore, por që është përkthyer në korrupsion nga kjo qeveri. Gënjeshttrat tuaja janë të pafundme. Vazhdoni me gënjeshttrat 3D për autostrada, aeroporte, porte, hekurudha e çfarë t'ju vijë në mendje. Ka 9 vjet që ka nisur Rruga e Arbrit dhe ju premtoni se do të inaugurohet brenda këtij viti, por kjo është një tjetër gënjeshtër, sepse ajo do, të paktën, edhe 7 vjet që të mbyllë lidhjen midis Tiranës dhe Peshkopisë. Ju flisni për minatorët, por ata marrin pagë më të ulët se 8 vjet më parë dhe janë në situatë kritike mbijetese dhe duhet të miratoni statusin e minatorit. Ju premtuat në vitin 2013 ujë vaditës për çdo parcelë dhe ujë të pijshëm për çdo familje, por asnjë njeri në qarkun e Dibrës nuk ka as ujë vaditës dhe as ujë të pijshëm.

Ju premtuat regjistrin kadastral urban dhe digjitalizimin e saj, por asnjë veprim nuk është bërë deri në këto momente në këtë qark. Ju premtoni se vitin tjetër përfundon hidrocentrali i Skavicës, i cili është një investim strategjik, por duhet parë në aspektin e rivitalizimit të zonës, duke komunikuar me qytetarët. Keni bllokuar regjistrimin e pronave në këtë qytet. Borxhi publik është 90%, nga 67% që ishte në vitin 2013. Unë nuk e di si mund të shkoni përsëri te 60%-shi në 4 vjet?! Ju flisni për punësim, familje, bujqësi e të tjera, por me taksat e larta të biznesit, me çmimin e lartë të energjisë dhe naftës e keni detyruar qarkun e Dibrës të kthehet nga një eksportues të produkteve bujqësore dhe blegtorale, në një importues.